**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS PARE DURRËS**

Nr.regj.themeltar 327
Data e regjistrimit 17.04.2014

Nr.Vendimit 327
Data 19.04.2014

# V E N D I M
## *"NË EMËR TË REPUBLIKËS"*

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË PREJ :

KRYETARI SEANCËS GJYQSORE ---- **FEJZO HYSI**

Asistuar nga **sekretaria Entila Shkurti** në Durrës më datën 19.04.2014 ora 09.00, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën Nr.327 që i përket :

**KËRKUES :** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës përfaqësuar nga **Prokuror Dritan Gina.**

**OBJEKTI** : Vendosje masë sigurimi pasuror, sekuestro preventive mbi këtë pasuri:

- Nr. i llogarisë 404569894,e çelur me datë 04/05/2012 në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetases . ose
- Nr. i llogarisë 404738709 çelur më datë 13/12/2013 në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetases .
- Pasuria nr. 12/40, vol 4 faqe 77, ZK 3225(fshati Rreth), tokë Are me sip 630 m2 në emër të .
- Pasuria me nr.27/44, vol 4, faqe 78, ZK 3225, (Fshati Rreth), tokë are me sip 2930 m2 në emër të
- Pasuria me nr 27/20, vol 4, faqe 79, ZK 3225, (fshati Rreth), tokë are me sip 2750 m2 në emër të .

**Baza ligjore** : Neni 36/b të K.Penal dhe N. 274/II, të K.Pr.Penale .

Gjykata pasi administroj aktet që i bashkëngjiten fashikullit të gjykimit, dëgjoj okurorin e çështjen që kërkoj të pranohet kërkesa sipas objektit të saj.

## V Ë R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës mbi bazën e referimit të kryer nga policia qësore pranë Drejtorisë së Policisë Qarku Durrës, ka regjistruar procedimin penal 8 Viti 2014 për veprën penale të " Pastrimit të produkteve të veprës penale "

parashikuar nga neni 287/1 germa " b" të K.Pr.Penale në ngarkim të shtetasit

Shtetasi . nëpërmjet të ardhurave financiare të realizuara nëpërmjet aktivitetit të pa ligjëshëm të tij dhe të djemëve të tij të cilët nga viti 2002-2005, shfrytëzonin si prostitute në Francë dhe Belgjikë shtetaset, Shtetasi i me venim nr. 146 datë 15.03.2007 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të " Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethna rënduese" në dëm të shtetasve dhe .) dhe aktualisht po invenston në prona dhe në pasuri në zona të ndryshmne të rrethit Durrës Në këtë mënyrë janë krijuar dyshime serioze se shtetasi nëpërmjet të përpunimit të ardhurave financiarë duke I invenstuar ato në prona dhe pasuri të ndryshme po kryer pastrimin e parave të rrjedhuara nga aktiviteti I tij criminal, duke konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal.

Nga verifikimet përkatëse në institucione shtetërore rezulton se:

Zyra Vendore e RPP Durrës në përgjigje të shkresë Prokurorisë Durrës te dates 11.11.2013 konfirmohet se shtetësja , ka te regjistruara tre pasuri tokë arë në fshatin Rreth Durrës dhe në relacionin shoqërues konstatohet kontratë shitje të dative 17 dhe 23 Janar 2013. Në emër të kësaj shtetase janë regjistruar këto pasuri:

- Pasuria nr. 12/40, vol 4 faqe 77, ZK 3225(fshati Rreth), tokë Are me sip 630 m2 në emër të
- Pasuria me nr.27/44, vol 4, faqe 78, ZK 3225, (Fshati Rreth), tokë are me sip 2930 m2 në emër të
- Pasuria me nr 27/20, vol 4, faqe 79, ZK 3225, (fshati Rreth), tokë are me sip 2750 m2 në emër të ,

Nga DPPP në përgjigje të shkresës date 01.11.2013 konfirmon faktin se shtetësja mbiemri I vajzërisë "Kola" ka lidhur një kontratë në da6te 17.01.2012 nëpërmjet të cilës ka blerë pasuri, tokë arë , truall dhe një ndërtesë në vlerë 10.913 263 lekë, ndërsa shtetësja ka depozituar në BKT më date 28.05.2013 shumën 25.000 euro.

Nga INUK Durrës vjenpërgjigje e shkresës date 05.11.2013 dhe konfirmohet fakti se shtetësja bija e ka pretenduar se po0 kryen ajo ndërtimin e një shtëpijë tre katëshe pranë shkollës së fëmijëve më aftësi të kufizuara apo pranë bar KJorça ashtu siç kallzon shtetësja

Drejtoria e Përgjithësme e Doganave vjen përgjigja e dates 11.12.2013 Prokurorinë Durrës më date 18.12.2013 dhe është konfirmuar fakti se shtetasit e kërkuar në listen e shkresë s Prokurorisë Durrës nuk figurojnë të kenë kryer veprime tregtare, doganore si import apo eksport.

***Ndërsa në përgjigje të Bankave të nivelit të dytë konfirmohet fakti se :***

BKTregtare në date 11.03.2014 konfirmon faktin se shtetësja ka në llogarinë e saj gjendje shumën 8.061 Euro çelur më 04.05.2012 së bashku me vajzën e saj shumën 1.127.30 Euro. Në

tërheqja nga banga kapin shumën 23.910.53 Euro viti 2012 dhe 63.053.41 Euro gjatë periudhës 2013-2014.

Në Credins Bank në date 10.03.2014 konfirmohet se se lëvizjet në depozitë në këtë bankë kapin vlerën 31.337.22 Euro por gjendja e saj deri në date 24.02.2014 është 79.35 Euro.

Në këtë procedim është adminustruar Vendimi Penal Nr. 146 datë 15.03.2007 I Gjykatës Rrethit Durrës që ka deklaruar fajtor shtetasin i sipas nenit 114/a/1,2,5 të K.Penal, vendim I cili ka marrë formën e prerë.

Sa më sipër shtetasi e tje.dyshohet për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale " parashikuar nga neni 287.1 germa "b" të Kodit Penal.

Gjykata e në analizë të faktiti të cuituar më sipër krijon bindjen se kërkesa e Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës duhet pranuar sipas objektit të saj në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në 36/b të K.Penal dhe N. 274.II, të K.Pr.Penale .

**V E N D O S I**

- ***Vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi këto pasuri :***
  - Nr. i llogarisë 404569894,e çelur me datë 04/05/2012 në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetases ose
  - Nr. i llogarisë 404738709 çelur më datë 13/12/2013 në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetases
  - Pasuria nr. 12/40, vol 4 faqe 77, ZK 3225(fshati Rreth), tokë Are me sip 630 m2 në emër të
  - Pasuria me nr.27/44, vol 4, faqe 78, ZK 3225, (fshati Rreth), tokë are me sip 2930 m2 në emër të ;
  - Pasuria me nr 27/20, vol 4, faqe 79, ZK 3225, (fshati Rreth), tokë are me sip 2750 m2 në emër të ;
  - Në referim të Nenit 279 pika 1 K.Pr.Penale veprimet hetimore janë sekret dhe për këtë shkak urdhërohet shtyrja e depozitimit në sekretari të këtij materiali.
  - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës.

**U shpall në Durrës më date 19.04.2014 ora 09.10**

G J Y Q T A R I

**FEJZO HYSI**

-Me vendimin nr.(10-2014-2500)282, datë 31/07/2014 të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur:
"Miratimin e vendimit nr.327 datë 19/04/2014 të Gjykatës së shkallës së Parë Durrës "

Konc.H.Hatillari

**KANCELARE**
**ARDENA VELI**

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
ARKIVA
Nxjerrë nga dosja
Nr. 327 dt. 19/04/2014
DURRËS